

MARRËVESHJE PËRFUNDIMTARE E BASHKIMIT TË SHOQËRIVE NËPËRMJET PËRTHITHJES

SHOQËRIA "ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS" SH.P.K.

Forma Juridike: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Selia: Njesia Bashkiake Nr.6, Rruga Fabrika e Qelqit, Zona Kadastrale 8230, Nr.Pas.2/63, Tirane.
Kapitali Themeltare: 280,000,000.00 Leke
Pjese e kapitalit: 100%
ORTAKET: Z. Artan Dulaku - zoteron 36% te kapitalit
Z. Adrian Dulaku - zoteron 26% te kapitalit
Z. Genci Dulaku - zoteron 25.5% te kapitalit
Z. Benjamin Feinberg - zoteron 12,5 % te kapitalit
NIPT K62115018I
Administrator: Znj. Juliana Guri

SHOQËRIA PËRTHITHËSE

DHE

SHOQËRIA "ELBASAN CABLE" SH.P.K.

Forma Juridike: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Selia: Njesia Bashkiake Nr.6, Rruga Fabrika e Qelqit, Zona Kadastrale 8230, Nr.Pas.2/63, Tirane.
Kapitali Themeltare: 100,00 LEKE
Pjese e kapitalit: 100%
Ortaku: Albanian Satellite Communications Sh.p.k
NIPT L33410202S
Administrator: Z. Altin Çobo

SHOQËRIA E PËRTHITHUR

Bien dakort për sa vijon:

1. OBJEKTI I MARRËVESHJES

Objekt i kësaj Marrëveshje është bashkimi nëpërmjet përthithjes i shoqërisë së Perthithur "ELBASAN CABLE" sh.p.k nga shoqëria Perthithese "ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS" shpk. Në këtë operacion bashkimi shoqëria "ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS" shpk do të jetë shoqëria përthithëse ndërsa shoqëria "ELBASAN CABLE" sh.p.k do të jetë shoqëria e përthithur.

Objekti i veprimtarisë për shoqërinë Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” shpk është:

Aktiviteti i shërbimit në fushën e telekomunikacionit dhe komunikimeve elektronike, transmetimit satelitor, transmetimit të të dhënave, figurë, video, kërkime, konsultime, projekte, organizim, shpërndarja e produkteve të teknologjisë së lartë, shitja dhe zbatimi i studimeve të ndryshme, shërbimi publik i telefonisë tokësore fiksetransmetimi i të dhënave etj; kryerja e veprimeve financiare dhe tregtare që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi me aktivitetin e saj, duke përfshirë këtu edhe zgjerimin e aktivitetit, krijimin e shoqërive të reja, si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të reja brenda dhe jashtë vendit. Të marrë për sipër transaksione në lidhje me pasuri të luajtshme dhe ose të paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës ose hipotekor i cili mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm nga administratori, në mënyrë që të përmbushet objekti i aktivitetit të shoqërisë, me kusht që këto aktivitete të mos tejkalojnë përcaktimet e sipërcituara; dhënia e linjave me qera; të kryejë aktivitete reklamuese; të zotërojë drejtpërdrejt ose tërthorazi, interesa në shoqëri të tjera të cilat kanë qëllime të ngjashme me ato të shoqërisë, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Kryerja e aktiviteteve financiare jo-bankare, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga autoritetet rregullatore kompetente, të cilat përfshijnë por nuk kufizohen vetëm tek arkëtimi dhe transferimi i parave. Kryerja e aktivitetit import – eksport në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga autoritetet rregullatore kompetente, shitjen dhe distribuicionin e pajisjeve të telekomunikacionit si dhe të cdo lloj produkti tjetër. Kryerjen e aktivitetit të transmetimeve dhe ritransmetimeve audio dhe audiovizive nëpërmjet sistemeve të telekomunikacionit për transmetimet dhe ritransmetimet audio dhe audiovizive të cdo lloji dhe në cdo lloj rrjeti si dhe shitjen e produkteve apo shërbimeve audio dhe video në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga autoritetet rregullatore kompetente.

Objekti i veprimtarisë për shoqërinë e Perthithur “ELBASAN CABLE ” sh.p.k është:

Televizion kabllor, shtrirje e rrjetit kabllor televiziv, radio, studio grafike. Ritrasmetim radio televiziv, bazuar në kabell koaksial dhe/ose fibra optike. Ritrasmetimin televiziv nëpërmjet internetit. Ritrasmetimin televiziv nëpërmjet satelitit. Prodhim, blerje, shitje, marrje me qera, dhenim marrje me hua të drejtash dhe veprash audiovizive me qëllim informimin dhe arzetimin e publikut për radio televizion. Ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Të dyja shoqëritë sa më lart, pra Shoqëria “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k dhe shoqëria “ELBASAN CABLE” sh.p.k hartojnë këtë projekt marrëveshje nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjor, bazuar specifikisht në Nenet 215, 216, 225 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Duke qenë se Shoqëria Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k është 100% Ortak i shoqërisë që do të përthithet Shoqëria “ELBASAN CABLE” sh.p.k, ky bashkim me përthithje do të realizohet bazuar në këtë Marrëveshje.

2. MOTIVET DHE QËLLIMI I BASHKIMIT

Bashkimi nëpërmjet përthithjes i shoqërisë “ELBASAN CABLE” sh.p.k nga Shoqëria “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k bëhet në kuadrin e riorganizimit të aktivitetit tregtar, përfshirë aktivitetin financiar dhe tregtar të Shoqërisë Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k.

OBJEKTI i veprimtarisë së shoqërisë Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k do të përfshijë dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë se Perthithur “ELBASAN CABLE” sh.p.k.

3. AKTIVET DHE PASIVET

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi shoqëria e Perthithur “ELBASAN CABLE” sh.p.k do t'i transferojë shoqërisë Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k tërësinë e elementeve të aktivitetit dhe pasivitetit sipas bilancit kontabël të vitit që përfundoi më 31.12.2020, duke marrë në konsideratë edhe çdo ndryshim të ndodhur deri në momentin e përthithjes që është data 31.12.2020.

Shoqëria Përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k dhe Shoqëria e Përthithur “ELBASAN CABLE” sh.p.k do të hartojnë pasqyrat financiare të muajit që përfundon më 31.12.2020, të cilat paraqesin vlerën kontabël të asetëve dhe detyrimeve të shoqërisë së përthithur më 31.12.2020, dhe do t'i bashkangjiten bilancit të shoqërisë përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k.

Të gjitha marrëdhëniet kontraktuale të lidhura nga shoqëria e përthithur “ELBASAN CABLE” sh.p.k dhe që janë në fuqi në datën e përthithjes, transferohen te shoqëria përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k., e cila merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga këto marrëdhënie kontraktuale.

4. DATA E PËRTHITHJES

Në aspektin juridik, data e përthithjes do të konsiderohet data e pranimit Zyrtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) dhe e lëshimit prej saj të Çertifikatës së Çregjistrimit të Shoqërisë së Përthithur “ELBASAN CABLE” sh.p.k. Efektet financiare dhe të kontabilitetit, përfshirë deklaratimet për Zyrën e Punës dhe për Organet Tatimore do të zbatohen nga data 01.01.2022. Të gjitha operacionet e veprimtarisë pas datës 01.01.2022, do të kryhen nga shoqëria përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k. Pas kësaj date çdo e drejtë apo detyrim, çdo veprim financiar, ekonomik apo administrativ do të kryhet nga Kompania Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k dhe do të pasqyrohet në kontabilitet nga shoqëria përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k.

5. TË DREJTAT DHE DETYRIMET ME PALËT E TRETA DHE ME INSTITUCIONET SHTETËRORE

Pas datës së përthithjes, Shoqëria “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k merr çdo të drejtë e detyrim që ka patur shoqëria e përthithur “ELBASAN CABLE” sh.p.k. në marrëdhëniet me të gjithë personat fizikë apo juridikë si dhe institucionet shtetërore, si organet tatimore vendore dhe qendrore, përfshirë Qendrën Kombëtare të Biznesit, Drejtorinë e Regjistrimit të Automjeteve, Zyrën e Punës, etj.

Shoqëria Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k do të jetë përgjegjëse për ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgjegjësiwe financiare, juridike dhe administrative me organet tatimore qendrore dhe vendore deri në çregjistrimin prej tyre të shoqërisë se Perthithur “ELBASAN CABLE” sh.p.k.

6. KAPITALI THEMELTAR

Duke qenë se Kompania Perthithese "ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS" sh.p.k ka ortak te shoqerise te njejtet ortake te shoqerise që përthithet Shoqeria "ELBASAN CABLE" sh.p.k., ky bashkim me përthithje nuk do të sjell ndryshim ne perqindjet e pjesemarjeve dhe ndryshim ne Kapitalin Themeltar të shoqërisë përthithëse nga bashkimi i kapitalit te shoqerive.

7. TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË VEÇANTA

Ky bashkim me përthithje nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë për ortakët, duke qenë se shoqëria përthithëse "ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS" sh.p.k ka te njejtet ortake dhe me kuota te njejta me shoqërine e përthithur "ELBASAN CABLE" sh.p.k.

8. MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

Punëmarrësit e shoqërisë së përthithur "ELBASAN CABLE" sh.p.k. do të transferohen në shoqërinë përthithëse "ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS" sh.p.k, nëpërmjet nënshkrimit të kontratave të reja të punësimit.


Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, shoqëria e Perthithur "ELBASAN CABLE" sh.p.k. dhe shoqëria Perthithese "ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS" sh.p.k, do të deklarojnë në organet tatimore respektive dhe në Zyrën e Punës largimin nga puna të punonjësve të Shoqerise se Perthithur "ELBASAN CABLE" sh.p.k. dhe marrjen e tyre në punë nga Shoqëria Perthithese "ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS" sh.p.k.

Shoqëria Perthithese

"ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS" shpk

Administratore

Znj. Juliana Guri



Shoqëria e Perthithur * Sh.p.k. *
"ELBASAN CABLE" sh.p.k

Administratori

Z. Altin Çobo



Hartuar në Tiranë më datë 14.12.2021